



Pozicioni i kontinenteve gjate permianit te vone

mjaft gjeografinë e Tokës. Masat e sotme kontinentale ishin krijuar dhe grumbulluar në superkontinentin e Pangjeas, përvec Azisë që filloi të shkëputet. Dallojmë një superoqean të quajtur Panthalasa (Deti i Bashkuar) dhe një det të vogël në lindje të Pangjeas i quajtur Tethys. Mungesa e deteve në brendësi të kontinentit i bënte ato të thata, me lëkundje të gjata stinore, dhe sasi të vogla reshjesh. Megjithatë disa prova tregojnë se klima filloi të ndryshonte dhe akujt filluan të pakësoheshin, ndërsa brendësitë e kontinenteve bëheshin më të thata.

Berthama e
brendshme e
ngurte

Permiani

290-248 milion vjet më pare

Në fund të Permianit ka ndodhur katastrofa më e madhe e zhdukjes masive të organizmave në historinë e tokës. Kjo katastrofë ka përcaktuar edhe kufirin e sipërm të Permianit i cili është njëkohësisht edhe kufiri midis Paleozoit dhe Mesozoit. Zhdukja preku masivisht komunitetin detar, duke shkaktuar këtu zhdukjen dërrmuese që kapi 90% të invertebratëve detarë. Ata që i mbijetuan kësaj nuk arritën asnjëherë dominimin ekologjik që kishin patur. Mbi tokë zhdukja nuk ishte aq e madhe sa në det. Katastrofa hapi rrugën për shfaqjen e grupeve të tjera të jetës. Kështu u krijuan kushtet e fillimit të të ashtuquajturës “Era e Dinosaurëve”. Pyjet me fiere u zëvendësuan nga gymnospermat, me filiza të mbështjella me farë. Jeta në tokë kishte filluar prapë të ndryshojë. Edhe lëvizja e pllakave e kishte ndryshuar